



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.02.2021, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rend i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së komisionit, datë 28 janar dhe 1 shkurt 2021.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit prej datës 8-26 shkurt 2021.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë për dhurimin në fushën e shëndetësisë”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha Gjebrea, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Eglantina Gjermani, Fatmir Velaj, Ervin Bushati, Ligoraq Karamelo, Andrea Marto, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Ediola Braha, Zef Shtjefni dhe Ditmir Bushati.

Mungojnë:

Rudina Hajdari, Halit Valteri dhe Reme Lala.

Të ftuar:

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Gelardina Prodani – Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Sot zhvillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 18.02.2021 me këtë rend dite: miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së komisionit, datë 28 janar dhe 1 shkurt 2021; miratimi i kalendarit të punës së komisionit prej datës 8-26 shkurt 2021, si dhe projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë për dhurimin në fushën e shëndetësisë”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe relatore do të jetë kolegja Gjermani.

Të ftuara kemi profesoreshë Mira Rakacollin, zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mirë se vini, profesoreshë Mira, dhe zonjën Prodani, sekretare e Përgjithshme po nga kjo ministri, së cilës, gjithashtu, i uroj mirëseardhjen!

Fillojmë pa humbur kohë me miratimin e procesverbaleve të datave 28 janar dhe 1 shkurt 2021. Nëse nuk ka ndonjë kundërshtim, shikoj që nuk ka; i konsideroj të miratuara.

Gjithashtu, kalendarin e punimeve të komisionit prej datës 8-26 shkurt, të cilin, në qoftë se nuk ka ndonjë vëzhgim apo kundërshti, shikoj që nuk ka, e konsideroj të miratuar.

Kalojmë, pa humbur kohë, te diskutimi i projektligjit.

Fjalën e ka profesoreshë Rakacolli. Për çfarë flet projektligji? Fjala për ju.

Mira Rakacolli – Faleminderit!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sjell përpara këtij komisioni për shqyrtim dhe miratim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë në lidhje me një donacion në fushën e shëndetësisë.

Parimi bazë i strategjisë së politikave shëndetësore të qeverisë sonë ka qenë gjithmonë ai i mbulimit universal shëndetësor, që do të thotë sigurimi i një shërbimi cilësor, të aksesueshëm, të përballueshëm për të gjithë, sa më afër vendbanimit, duke pasur gjithmonë qytetarin në qendër.

Në fakt, ne jemi dëshmitarë që gjatë gjithë këtyre kohëve politikat kanë shkuar gjithnjë në këtë drejtim. Mjafton të përmendim ndryshimet e thella që janë bërë në infrastrukturë qoftë me programin e 300 qendrave shëndetësore, qoftë me spitalet e reja rajonale të ndërtuara, siç është, për shembull, ndërtimi që po bëhet në spitalin e Kukësit,

rikonstrukcioni i spitaleve ekzistuese rajonale, ndërtimi i materniteteve, pajisjet mjekësore, të cilat tashmë kanë pësuar një ndryshim shumë të madh në nivelin e shërbimit cilësor që ato ofrojnë dhe mjaft të tjera, të cilat qytetarët i prekin çdo ditë. Por, pa dyshim, ka shumë më tepër për të bërë. Pa dyshim që fatkeqësisht mbeten ende shërbime cilësore dhe aparatura ose ekzaminime, të cilat mund të kryhen vetëm në qytetin e Tiranës, duke krijuar kjo një vështirësi për qytetarët.

Për këtë arsye, qeveria e Shqipërisë ka lidhur një marrëveshje me qeverinë turke për të pranuar një donacion për një spital të ndërtuar në qytetin e Fierit, i cili do të jetë i një niveli ose, më saktë, do të ofrojë një nivel shërbimi shëndetësor për të gjithë rajonin e Jugut që sot për sot nuk ofrohet në asnjë prej spitaleve rajonale të këtij regjioni dhe në të gjithë regjionin e Jugut.

Ky spital do të ketë, siç e thashë, 150 shtretër, do të ndërtohet tërësisht nga pala turke, përfshirë këtu mobilimin dhe aparatura mjekësore të një teknologjie të lartë, të cilat, siç e thashë, do të ofrojnë sigurimin e një shërbimi shëndetësor cilësor për të gjithë banorët e regjionit të Jugut, sa më afër vendbanimit të tyre.

E rëndësishme është që qeveria turke është zotuar që ta bëjë këtë spital shumë shpejt, brenda tre muajve që nga nënshkrimi i marrëveshjes. Natyrisht, një angazhim i tillë dhe një përshpejtim i tillë i punëve që duhen për ta ndërtuar dhe për ta pajisur këtë spital kërkon një angazhim të rëndësishëm edhe nga pala shqiptare.

Për këtë arsye në marrëveshje presupozohet që palët të bien dakord që të gjitha ato procedura, të cilat kanë të bëjnë me procedurat doganore ndërmjet dy vendeve apo me taksat e tarifave që duhen në këto raste, të jenë të reduktuara dhe ato aparatura, pajisje ose materiale ndërtimi, të cilat duhen për sigurimin e këtij spitali që vijnë nga Republika e Turqisë të jenë të përjashtuara nga taksat e tatimet, si dhe ato të cilat do të blihen në Shqipëri të jenë të përjashtuara nga taksa e vlerës së shtuar.

Nga ana tjetër, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë në këtë marrëveshje rezervon të drejtën që për të ndërtuar spitalin dhe për të siguruar të gjitha llojet e pajisjeve t'i zgjedhë vetë dhe të bëjë kontrata të ndara me kontraktuesit me kompani turke ose/dhe të përzgjedhura vetë prej saj. Ne mendojmë se është një marrëveshje mjaft e favorshme. Ajo parashikohet të hyjë në fuqi atëherë kur është nënshkruar, që është në shkurt të vitit 2021 nga palët përkatëse që kanë qenë përgjegjëse për realizimin e kësaj marrëveshjeje, nga zëvendësministri i Shëndetësisë (pala turke) dhe nga ambasadori ynë në Turqi (pala shqiptare).

Mendojmë se është një spital i cili do të sjellë patjetër një rritje të nivelit të kujdesit shëndetësor për të gjithë banorët e qyteteve të Jugut. Prandaj ju ftojme që pas një diskutimi ta miratoni.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, profesoreshë Rakacolli!

Zonja Gjermani, fjala është për ju.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja kryetare!

Përsëndetje të gjithëve!

Faleminderit, zonja Zëvendësministre për shpjegimin shterues!

Unë përfitoj nga rasti, në fakt, të shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tonë për të gjithë kontributin dhe angazhimin tuaj në gjithë këtë periudhë shumë të vështirë për të gjithë ne, ju si ministri, dhe të gjithë ekipit të bluzave të bardha, sepse mendoj se është një nga periudhat më të vështira që po kalojmë.

Ndërkohë, pa dyshim, shpreh edhe mirënjohjen për qeverinë turke që na është gjendur pranë në periudha shumë të vështira, edhe në periudhën pas tërmetit, edhe tani në kulmet e pandemisë me këtë dhurim të një spitali që ka filluar punën të ndërtohet në Fier për të gjithë rajonin e Jugut.

Ne, si Komisioni i Politikës së Jashtme, e shqyrtojmë këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi dhe me procedurë normale, pavarësisht se është kërkuar të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar.

Me anën e kësaj marrëveshjeje mes Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, pala turke ka marrë përsipër t'i dhurojë palës shqiptare një spital me 150 shtretër që ka filluar punën të ndërtohet në Fier. Pajisjet mjekësore, materialet dhe orenditë, si të thuash, të gjitha janë të dhuruara brenda kësaj marrëveshjeje që ne e diskutojmë sot.

Mendoj që është një kontribut i rëndësishëm jo vetëm për të gjithë rajonin e Jugut për ofrimin e një shërbimi shëndetësor me standarde të larta, por edhe për të gjithë Shqipërinë, sepse duke u mbuluar pjesa e Jugut, sigurisht që ulen kapacitetet dhe mbulohet pjesa tjetër me ato kapacitete që kemi.

Republika e Turqisë do të përcaktojë personelin e kujdesit shëndetësor gjatë fazës së tranzicionit në spital dhe do të ofrojë këshillim nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Turqisë. Ky mendoj se është një avantazh dhe një pikë shumë e fortë e kësaj marrëveshjeje, sepse rrit edhe kapacitetet dhe ofron shërbim shëndetësor të një niveli të lartë, gjë për të cilën, në fakt, Turqia dallohet.

Mendoj që ky spital është investim shumë i rëndësishëm në fushën e shëndetësisë dhe do të ofrojë shërbim të kualifikuar, teknologji të lartë mjekësore për të gjithë këtë rajon. Ndaj, pa diskutim, do t'i ftoja të gjithë kolegët ta miratojmë. Sërish falënderojmë qeverinë turke për këtë kontribut, për këtë donacion të vyer.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Gjermeni!

Hapim diskutimin.

Ka pyetje? Fjalën e ka nënkryetari Gjoni.

Ralf Gjoni –Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Zëvendësministre, ju falënderoj për prezantimin!

Në fakt, çdo donacion nga një vend mik si Turqia është i mirëpritur, sidomos në fushën e shëndetësisë, ku Republika e Turqisë ka një zhvillim,do të thosha të jashtëzakonshëm, krahasuar edhe me vende të zhvilluara të Bashkimit European.

Meqenëse ne jemi komision për dhënie mendimi, duke mos dashur që të bëj edhe politikë të brendshme, janë disa aspekte që lidhen me gjeopolitikën sa herë që bëhet fjala për marrëveshje donacionesh, sidomos në fushën e shëndetësisë, nga vende si Turqia, Rusia, Kina dhe vende të tjera, që kanë disa sfida gjeopolitike *vis a vis* Perëndimit, ku ne pretendojmë të aderojmë Së pari, pse me procedurë të përshpejtuar? Mos ndoshta ju keni një pritshmëri për sa i përket shtimit të infektiveve dhe nevojshmërisë së pacientëve me COVID? Pra, spitali i Fierit do të jetë për COVID-in apo do të jetë një spital që do t'u përgjigjet nevojave të përgjithshme të shëndetësisë për Jugun?

Personalisht unë mendoj që është gjë shumë e mirë të kemi një, dy apo tre spitale të reja, është ndihmë fantastike, por shpeshherë ka aludime, edhe në mediet perëndimore, ndoshta me të drejtë, ndoshta me të padrejtë, që vende si Turqia janë duke shtrirë influencën e tyre politike në vendet e Ballkanit duke përdorur donacione të tilla.

Së dyti, a keni dijeni ju, zonja Rakacolli, për ndonjë kushtëzim të pashkruar politiko-fetar nga ana e Republikës së Turqisë, i cili është i lidhur me këtë donacion për spitalin e Fierit?

Së treti, pse nga Turqia dhe jo nga Bashkimi European? A kemi kërkuar ne si shtet apo qeveri ndihmë nga Bashkimi European për ndërtimin e një spitali të tillë? Po presupozoj që ka pasur një nevojë emergjente në Fier për të hapur një spital. Derisa i është kërkuar ndihmë për ndërtimin e këtij spitali qeverisë turke, po presupozoj që kjo nevojshmëri është ndarë edhe me aleatë të tjerë, qoftë në Bashkimin European apo edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës pse jo. Pra, a keni kërkuar ju nga BE-ja dhe SHBA-të ndihmë shëndetësore për

ngritjen e këtij spitali dhe nëse po, jeni përballur më një refuzim nga ana e tyre për të na ndihmuar në fushën e shëndetësisë që ne detyrohemi t'i lutemi Turqisë për një donacion?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Përpara se t'ia jap fjalën zëvendësministres, dua të pyes nëse ka pyetje të tjera. Për momentin nuk ka pyetje apo komente të tjera.

Përpara se profesoreshë Rakacolli të japë përgjigjen, dua të rikthej në vëmendjen e kolegëve dhe jo vetëm, që ne nga Bashkimi Europian kemi marrë 1,2 miliardë euro donacione, ndihma, kredi të buta, grante për rindërtimin e vendit pas tërmetit. Pra, jo se ne nuk kërkojmë ndihmë në Bashkimin Europian dhe ata nuk përgjigjen.

E dyta, Turqia është një partner i rëndësishëm strategjik i Shqipërisë dhe një aleat në NATO. Pra, nuk shikoj asgjë të gabuar në gjeopolitikën e qeverisë, përkundrazi, shikoj një diversifikim të marrëdhënieve, të donacioneve të ecejakeve, të nëm-nameve që ne, në fakt, duhet të përballim. Kemi qenë dhe vazhdojmë të jemi në një periudhë jashtëzakonisht të vështirë, unikale, për sa i përket 100-vjeçarit të fundit, siç është ajo e pandemisë. Për aq kohë sa ekonomia Turke mund t'ia lejojë vetes një dhurim të tillë, donacione të tilla janë më shumë se sa të mirëpritura të vijnë nga cilido vend mik, partner dhe aleat. Gjithsesi, zonja Rakacolli, nëse keni ndonjë gjë për të shtuar, fjala është për ju

Ralf Gjoni – Kryetare, më fal! Ju lutem, për procedurë!

Jo vetëm si nënkryetar, por edhe si anëtar i opozitës në këtë komision, unë kam të drejtën time, edhe në procedurë, edhe kushtetuese, që të ushtroj detyrën time si deputet dhe të bëj pyetje, sidomos pyetje që lidhet drejtpërdrejt me marrëveshjet që ne kalojmë, sidomos me marrëveshje ndërkombëtare që kërkohet të kalohen me procedurë të përshpejtuar.

Do t'ju lutesha shumë miqësisht që kur unë i bëj pyetje zëvendësministres, përfaqësueses së ekzekutivit, nuk është e nevojshme për filtrim. Unë mendoj që zëvendësministrja duhet të përgjigjet dhe nuk është për të shtuar, sepse pyetja nuk ishte për ju. Unë nuk kam nevojë për shtesa të zonjës Rakacolli ndaj komenteve tuaja. Unë bëra një pyetje dhe ngrita një shqetësim, që është i ngritur nga Uashingtoni, nga Brukseli dhe nga shumë struktura të sigurisë ndërkombëtare, që Turqia është duke shtrirë influencën e saj në Ballka. Unë kam të drejtë ta bëj këtë pyetje dhe pres një përgjigje nga zëvendësministrja, por, ju lutem, jo si shtojcë e komenteve. Secili deputet, kryetar, nënkryetar apo anëtar i thjeshtë, mund të bëjë komente, por jo për t'i dhënë përgjigje njëri-tjetrit, sepse mendoj që këtë detyrë e ka ekzekutivi që duhet ta japë para komisionit.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti Gjoni, e para e punës, përveçse jam kryetare e komisionit, unë jam deputete e Kuvendit të Shqipërisë, me të drejta të barabarta me ju për të bërë komentet që unë mendoj se duhen bërë në këtë tryezë, jashtë saj dhe në të gjitha tryezat që, bazuar në Kushtetutë, kam të drejtën t’i bëj këto komente. Pra, jam njësoj si ju, pavarësisht se drejtoj këtë mbledhje dhe jam në të drejtën time për ta bërë këtë gjë.

E dyta, profesoreshë Rakacolli është zëvendësministre e Shëndetësisë. Pavarësisht se mban një pozicion politik, si ai i zëvendësministrit, ajo është eksperte në fushën e shëndetësisë, ndërkohë që ne po flasim totalisht për një gjë tjetër.

E treta, e ritheksoj, qeveria e ka kërkuar me procedurë të përshpejtuar ratifikimin e marrëveshjes, ndërkohë që ju siguroj, që, bazuar në Rregulloren që rregullon mbarëvajtjen e punëve të parlamentit dhe të komisioneve, nuk kemi asnjë procedurë të përshpejtuar, përkundrazi, po zhvillohet një mbledhje komisioni të zakonshme si çdo herë tjetër. Thënë këto, ju keni të drejtën të pyesni, por unë kam të drejtën të pyes, të bëj komente njësoj si ju, sepse jam një anëtar i parlamentit siç jeni edhe ju.

Fjalën e kanë, zoti Bushati, zonja Gjermani dhe më pas do të përgjigjet zëvendësministrja Rakacolli.

Ditmir Bushati – Zonja kryetare, faleminderit!

Nuk e di si është në procedurë, por paraprakisht unë do të doja të shprehja mbështetjen për projektin që ka ardhur nga ana e qeverisë për sa i përket kësaj nisme. E përshpejtuar apo me procedurë normale, besoj se kjo është një çështje që është vendosur në Konferencën e Kryetarëve. Nuk është domosdoshmërisht pjesë e punës sonë, sado që secili prej nesh mund të ketë këndvështrimin e tij për procedurat parlamentare. Gjithsesi, besoj se këtu duhet të nisemi nga objektivat që kanë lidhje me humanizmin dhe me emergjencën. Ndërtimi i këtij spitali është i mirëpritur. E çmoj të drejtën e çdo kolegu për të bërë pyetje dhe komentet e tij, por nga ana tjetër besoj se do të ishte më normale që të kishim pak më shumë informacion rreth kapaciteteve që do të alokohen për këtë spital.

Unë e dëgjova profesoreshë Rakacollin dhe ideja është që do t’i shërbejë të gjithë Jugut të Shqipërisë. Në kushtet kur Shqipëria ka sfida përpara për sa i përket kapaciteteve në shërbimin shëndetësor, qoftë me mjekë, qoftë me personelin tjetër, njëra anë është infrastruktura fizike e shërbimit dhe ana tjetër është ajo humane. Pra, në këtë drejtim unë do të doja të kishim pak më tepër informacion rreth planeve të qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Në qoftë se do të ishte e mundur, duke qenë se shumë shtetas shqiptarë marrin trajtim shëndetësor në Turqi, kam një pyetje në raport me pritshmërinë. Pra, do të kemi një

reduktim të numrit të shtetasve shqiptarë që do të shkojnë për të marrë trajtim shëndetësor në Turqi dhe cili është parashikimi në këtë drejtim, pra do të kemi një ulje për 1 vit, për 2, për 4, për 5 vjet dhe rrjedhimisht edhe ulje të kostove dhe të shpenzimeve apo ky spital do të ketë një natyrë tjetër?

Së fundmi, në lidhje me shqetësimin që u ngrit. Unë besoj se Turqia është një partner rajonal i çmuar i Shqipërisë dhe Shqipëria është hapur për të bashkëpunuar, jo vetëm me Turqinë, por edhe me vende të tjera, për sa kohë që ky lloj bashkëpunimi shtrihet brenda perimetrit të vlerave dhe të parimeve të familjes sonë euroatlantike, aq më tepër që me Turqinë, siç e thatë edhe ju, zonja kryetare, ne jemi në të njejtën tryezë në NATO. Mendoj se, në kushtet kur vende të tjera të rajonit, nuk u janë përmbajtur asnjë prej vlerave dhe parimeve mbi të cilat janë angazhuar në NATO apo në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin European, vendi ynë si rrallë kush u ka rezistuar tundimeve që kanë ardhur nga aktorët dhe faktorët të tretë në rajon dhe besoj se ndërtimi i një spitali qoftë nga një vend aleat i çmuar, siç është Turqia, por edhe nga ndonjë vend tjetër do të ishte i mirëpritur, nesër ose pasnesër.

Më lejoni t'ju kujtoj që, ne kemi shumë shkolla në Shqipëri, nuk po flas për institucionet e kultit, por për shkollat e financuara apo të dhuruara me fonde nga vende të botës arabe, vende të Gjirit Persik, nga fqinje të çmuara siç janë Italia dhe Greqia e kështu me radhë. Prandaj, besoj se nuk është mirë të hyjmë nëpër debate, që nuk kanë domosdoshmërisht lidhje me këtë veprim që është ndërmarrë, i cili në gjykimin tim është një vendim dhe veprim i drejtë. Ku ta gjejmë që të bëhet e njëjta gjë edhe me Italinë, të bëhet e njëjta gjë edhe me Greqinë, mundësisht dhe me vende të tjera të Bashkimit European edhe pse jo edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për sa kohë jemi të sigurt që ato parime dhe ato vlera për të cilat ne jemi angazhuar, qëndrojnë aty dhe të palëkundura.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit zoti Bushati!

Zonja Gjermani!

Eglantina Gjemeni – Faleminderit kryetare!

Unë e dua fjalën për procedurë, pikërisht të theksoj atë që thashë gjatë relatimit, që ne po e diskutojmë me procedurë normale, megjithëse kjo më duket çështje teknike në këto kushte. Dhe duke respektuar në fakt të gjitha pyetjet dhe angazhimin e të gjithë deputetëve, kërkoj mbështetje dhe vlerësim, që në një situatë të tillë, kaq të vështirë, me kapacitete të limituara, me kushtet e një vendi të vogël, ne vërtet e mirëpresim dhe e vlerësojmë si një ndihmë të jashtëzakonshme, në këtë periudhë që po kalojmë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Gjermeni!

Profesoreshë Rakacolli.

Mira Rakacoli - Faleminderit!

Atëherë, duke u nisur nga pyetja e parë e deputetit Gjoni, në lidhje me COVID-in në këtë spital, në fakt, shëndetësia shqiptare përveç COVID-it duhet të përballojë edhe plotësimin e nevojave për sëmundje të tjera të të gjithë qytetarëve. Në fakt, ky spital shkon më tepër në drejtim të këtyre nevojave. Pra, vërtet është një spital, pa dyshim si gjithë spitalet e tjera. Do të ketë një pavion që do të ofrojë shërbim për sëmundjet infektive dhe jo vetëm për COVID-in. Kryesorja është që në këtë spital do të ofrohet shërbim shëndetësor cilësor, që nuk është ofruar deri tani për pacientët e jugut afër vendbanimit, por është ofruar vetëm në Tiranë, siç është për shembull, hemodinamika, që bëhet vetëm për vendosje stendesh sot në qytetin e Fierit, por do të ketë edhe vendosje të pajisjeve të tjera, siç janë *pacemaker* apo siç janë procedurat e tjera që i shërbejnë urgjencës.

Gjithashtu, dihet që sa më shpejt të arrish në spital afër vendbanimit, aq më mirë dhe me cilësi është e mundur ta marrësh ndihmën. Është menduar që në këtë spital të ketë një shërbim neurologjie, i cili do të ofrojë trombolizën, e cila sot për sot bëhet vetëm në Tiranë dhe natyrisht që është një procedurë e cila duhet të kapë disa orë të caktuara momenti i ndodhjes së ngjarjes, deri në momentin e arritjes në spital, gjë që e vështirëson arritjen nga të gjithë qytetet e vendit.

Pra, bërja e kësaj qendre atje do të jetë një vlerë e shtuar, për t'i shërbyer urgjencës së sëmundjeve vaskulare të trurit. Do të ketë shërbime kirurgjikale të avancuara, ato që sot për sot, bëhen vetëm në Tiranë apo që dërgohen edhe jashtë shtetit, sepse nuk arrihet të bëhet edhe në Tiranë. Pra, është ajo që u tha që, ka persona të cilët për të bërë këtë lloj ndërhyrjeje duhet të shkojë jashtë shtetit. Pra, do të ketë edhe shërbime të tjera, do të ketë dhe një kabinet kardiologjie të dedikuar, për një vlerësim të plotë të funksioneve kardiake, do të ketë edhe një pavion ose një shërbim të dedikuar për vlerësimin e plotë të sëmundjeve pulmonare, do të ketë një shërbim të dedikuar për vlerësimin e plotë të funksioneve të aparatit dixhestiv, pra të ezofagut të stomakut. Do të ketë një kabinet endokrinologjie, do të ketë edhe një kabinet hematologjie, dhe një tjerët kabinet të sëmundjeve të veshkave, pra të nefrologjisë. Pra, ajo që duket është një spital i një niveli tercial, pra shërbime të cilat qytetarët shqiptarë kanë arritur t'i marrin vetëm në Tiranë dhe ndoshta në klinika më të specializuara jashtë vendit.

Siç e tha edhe e nderuara kryetare, zonja Kodheli, në përballimin e pandemisë ne kemi qenë në marrëveshje me shume vende. Natyrisht, dihet që Bashkimi European na ka asistuar me një ndihmë shumë të madhe prej 4 milion eurosh, të cilat janë përdoruar për të

shtuar kapacitetet teknike të spitaleve tona, por kanë qenë kryesisht në drejtim të COVID-it. Ndërsa, ky spital do të jetë një spitali, i cili përveç një shërbimi modest, dua të them, të infektivit, do të jetë më tepër një rritje e nivelit cilësor të shërbimit në të gjithat fushat e shëndetësisë, për të cilat kanë nevojë qytetarët. Pra, është patjetër një zhvillimi cilësor i shëndetësisë shqiptare dhe është një ndihmë shumë e madhe për të gjithë banorët e jugut dhe jo vetëm, për disa lloj ndërhyrjesh të cilët, siç e thashë edhe pak më përpara, një pjesë e qytetarëve janë të detyruar t'i marrin në struktura jashtë Shqipërisë, në Turqi ose dhe gjetkë.

E rëndësishme është, siç e tha edhe zonja Gjermani në relacionin që paraqiti, që në këtë spital do të ketë edhe një asistencë teknike edhe nga mjekë turq, pra do të shërbejë edhe si një qendër për të rritur edhe nivelin teknik të burimeve tona njerëzore, të cilat vërtet janë jo aq sa ne do të duam të ishin, por që në projektimin e këtij spitali janë menduar mirë. Janë menduar mirë edhe sesi ato do të jenë të alokuara, edhe sesi do të funksionojë.

Pra, është një spital që patjetër do të rrisë nivelin e shërbimit shëndetësor në Shqipëri.

Mimi Kodheli – Faleminderit doktorëshë!

Mirë, nëse nuk ka komente të tjera, atëherë, kolegë, ju ftoj ta hedhim në votim.

Kush është dakord me projektligjin? Shikoj që jemi të gjithë dakord.

Ju falënderoj!

Faleminderit nënkryetar!

Faleminderit Vasil!

Faleminderit Zef!

Faleminderit kolegëve!

Faleminderit Alket!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Shikoj që miratojmë marrëveshjen në unanimitet të plotë.

Neni 1. Kush është dakord? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Neni 2. Ju faleminderit!

Edhe një herë në tërësi.

Ju falënderoj për bashkëpunimin!

Faleminderit, profesorëshë Rakacolli!

Faleminderit, zonja Prodani!

Faleminderit për bashkëpunimin!

Shihemi në mbledhjen e radhës, të martën.

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA